



|  |              |
|--|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |              |
| KOMUNA E VUSHTRRISË - OPITINA VUČITRN  |              |
| 01 Nr. / Br.                           | 79/20        |
| Nr. i Sq. / Br. st.                    | - 3 -        |
| Data: / Datum                          | 28. 05. 2020 |
| VUSHTRRI - VUČITRN                     |              |



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,  
MBAJTUR MË 6 MARS 2020**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 14:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Habibe Gérxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Ali Januzi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Gentiana Rama, Hysni Gërguri, Melihate Basholli-Latifë, Suzana Syla, Miljan Bojković, Fitim Halili, Safet Idrizi, dhe Teuta Aruç Shartari.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkyetari i komunës z. Besim Muzaqi, komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**RENDITE**

**1. Shënim i 22 - vjetorit të "Epokesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", si dhe i rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari, Dëshmorëve të Kombit dhe të gjithë të rënëve përliri.**

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** - pasi hapi mbledhjen tha se jemi takuar sot në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, e cila është përcaktuar meagjendën e Qeverisë të Republikës së Kosovës, për ndër të shënimit të 22-vjetorit të Epokesë së UÇK-së, gjegjësisht rënies heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij.

Konform nenit 10 të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me të cilën rregullohet mbajtja e mbledhjeve solemne po e hapim takimin e sotëm dhe fjalën ia kaloi kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z. Xhafer Tahiri.

**Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës së Vushtrrisë:**

**Inderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Nasuf Aliu,**

**Inderuar Nënkyetar i Komunës z. Besim Muzaqi,**

**Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,**

**Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta,**

**Të nderuar familjar të dëshmorëve dhe martirëve të luftës,**

**Të nderuar përfaqësues të Policisë së Kosovës, të KFOR,**

**Të nderuar përfaqësues të Bashkësive fetare,**

**Të dashur qytetarë të Vushtrrisë,**

**Zonja dhe zotërinj,**

Jam shume i nderuar që sot në ketë seancë soleinne, të ju drejtohem ju dhe qytetarëve tanë. Ne sot, kujtojmë me përulësi të gjithë dëshmorët e rënë përliri që sakrifikuani jetën e tyre në altarin e lirisë, por askush nuk sakrifikoi si Mësuesi Shaban Jashari me bijtë e tij, Ademin, Hamzën dhe tërë familjen e tyre që u vranë barbarisht nga forcat serbe në Marsin e vitit 1998. Andaj sot ne po shënojmë ditët e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Të nderuar,**

Sot që jemi të lirë e të pavarur, ne marrim mësimë shembullore nga vepra jetësore e Adem Jasharit dhe e Ibrahim Rugovës. Që të dy, si dhe shumë veprimitarë e ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me veprat e tyre jetësore plotësojnë mozaikun e Kosovës së lirë e të pavarur. Pra, ne jemi me fat që kemi mundësi t'i shërbejmë shtetit tonë të pavarur, Kosovës, atdheut tonë të dashur. Asnjë individ, asnjë grupim politik, feta a etnik nuk është më i rëndësishëm se Republika e Kosovës e krijuar me shumë sakrificë nga të gjithë. Tani kur i shërbejmë kësaj Republike, detyra jonë themelore është që të respektojmë ligjin, të ndërtojmë një shtet të drejtë e të barabartë, me mundësi përliri të gjithë. Një shtet ku ne e fëmijët tanë kanë një të ardhme të ndritur, një shtet që e bënë krenar Adem Jasharin e Ibrahim Rugovën e ne duhet të japim maksimumin tonë që dëshmorët dhe të renit të pushojnë të qetë e gjaku i tyre të jetë dritë përliri Kosovën. Këto data të bekuar na kujton rrugën e vështirë nëpër të cilën kaluam ne si popull po ashtu kthejnë shpresën përliri një të ardhme më të mirë përliri të gjithë qytetarët. Në këto dite, të gjithë ne përulemi para kujtimit përliri të gjithë ata që u fljuan përliri dhe pavarësinë e Kosovës, atdheut tonë të shtrenjtë që u la me gjakun e dëshmorëve. Sot dhe çdoherë ne do të punojmë që sakrifica dhe gjaku i derdhur asnjëherë mos të harrohet, por të kemi motiv përliri të punuar drejt, e kështu ti nderojmë dhe respektojmë dëshmorët me pune e ndershëmëri. Sot, si çdo herë tjeter, ne ripërsëritim falenderimin tonë të

përherershëm për të gjitha vendet mike që na dolën në ndihmë në orët e ditët më të vështira të historisë së popullit tonë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian, si dhe të gjitha vendet e tjera, të cilat ndërhynë në Kosovë, dhe shpëtuan popullin e Kosovës nga rreziku i zhbërijes fizike. Shpëtimi i popullit të Kosovës nga forcat e agresorit, pa dyshim, paraqet veprimin më të madh që ka ndërmarrë bota demokratike në emër të humanizmit dhe të lirisë dhe ne do te jemi mirënjojës përgjithmonë. Vendoseshmëria e popullit tone për të qene të liri beri që bota demokratike të jete në anën tone kjo është mërit e të gjithëve që dhanë kontribut në çfarëdo forme që munden veten dhe nuk kësyen as jetën e tyre.

Të dashur qytetar të Vushtrrisë,

Të nderuar të pranishëm,

Shumë shpejtë Vushtrria do të përuroj sheshin Kolonel Ahmet Krasniqin, e bashkë me sheshet “Hasan Prishtina” e “Adem Jashari”, këto sheshe do të ja shtojnë vlerat historike e kulturore qytetit tonë, ndërsa kështu ne përjetësojmë kujtimin për luftën heroike të popullit të Kosovës për liri, kështu nderojmë dhe përjetësisht i respektojmë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës,

Zoti i bekoftë Ushtarët e UÇK -së, familjen Jashari.

Zoti e bekoftë Vushtrrinë,

Zoti ju bekoftë Ju të gjithëve.

Mbledhja përfundoi në ora 14:21.

Bastri Duraku

  
Procesmbajtës

Nasuf Aliu

  
Kryesues i Kuvendit

